



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/02-4045  
Datë 15.03.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 12 të Udhëzimit Administrativ (MASH) numër 151/2020 për Detyrat dhe Përgjegjësitë e Drejtorit dhe të Zëvendësdrejtorit të Institucionit Publikë Edukativo-Arsimor dhe Aftësues Para Universitar në Republikën e Kosovës, Procedurat e Zgjedhjes dhe Emërimit, Përfundimit të Kontratës dhe Emërimit të Përkohshëm, me datë 15.03.2024 merr këtë:

### V E N D I M

1. Nëpunësi **Majlind Ferdulli** caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të SHFMU “Emin Duraku” nga data **16.04.2024** deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit për zgjedhjen e drejtorit të ri.
2. Caktimi i kryesit të detyrës së drejtorit është i përkohshëm ngase procedura e vlerësimit/rekrutimit do të zhvillohet sipas rregullave ligjore përkatëse.
3. Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) muaj, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Autorizohen organet kompetente që të vazhdojnë pagesën e të ardhurave personale në lartësi të koeficientit të paraparë për pozitën e Drejtorit të SHFMU.
5. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

#### Vendimi iu dorëzohet:

- Nëpunësit Majlind Ferdulli
- Drejtorisë për Arsim
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini  
  
Kryetar i Komunës së Gjakovës

